



# EDUKIMI MBI MEDIAN DHE INFORMACIONIN NË EPOKËN DIGJITALE: SFIDA E SHQIPËRISË

**Dr. Jonila Godole**

*Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit, Universiteti i Tiranës*

*Drejtoresha e Institutit për Demokraci Media dhe Kulturë (IDMC)*



*Ky dokument është prodhuar me ndihmën financiare të Bashkimit Europian. Përgjegjësia e vetme për përmbajtjen e këtij dokumenti është e Institutit Shqiptar të Medias si partner i projektit “Media për Qytetarët – Qytetarët për Median” dhe në asnjë rrethanë nuk mund të konsiderohet se reflekton pozicionin e Bashkimit Europian.*

## Hyrje

Për të rinjtë e sotëm, përdorimi i internetit dhe rrjeteve sociale si burim i përditshëm informacioni është i vetëkuptueshëm. Për ta përdorur internetin në mënyrë sa më efektive nevojiten sidohet disa aftësi dhe mekanizma reflektues për t'i përdorur burimet e mediave (online) në mënyrë kritike, dhe këto kompetenca përfshihen kryesisht te edukimi mbi median dhe informacionin (EMI). Studiuesit mendojnë se ekzistojnë lidhje të ngushta midis aftësive individuale të leximit të përmbajtjeve mediatike dhe aftësisë për t'u përfshirë në proceset e demokracisë si një qytetar aktiv dhe i informuar. Duke pasur parasysh ndryshimet në peizazhin e mediave dixhitale që kanë bërë të mundur përhapjen në masë të lajmeve të rreme, disa ndryshime në konceptin tonë të EMI-t janë mëse të nevojshme: Tani kërkohet më shumë aftësi dhe kujdes në mënyrën e të lexuarit kritik të përmbajtjeve në internet.

Në politikat e shkollimit kjo do të ishte themelore për t'u dhënë mundësi të rinjve të ndjehen më të sigurt përballë burimeve të larmishme të lajmeve online, të mësojnë perspektiva të reja dhe t'i përdorin këto aftësi në shkollë, ose në bisedat me moshatarët e tyre, me mësuesit dhe familjen. Përfshirja e praktikave kritike të EMI-t gjatë leximit të teksteve do t'i lejonte nxënësit të sfidojnë materialin që lexojnë, mbështetur në aftësitë e tyre ekzistuese të të kuptuarit. Roli i EMI-t në mënyrë kritike duhet të shihet si një qasje gjithë-shkollore, ndërkurrikulare që inkurajon nxënësit të sfidojnë atë që lexojnë duke bërë pyetje kritike ose duke paraqitur këndvështrime të ndryshme. Në një kontekst më afër ekspozimit ndaj mediave sociale, EMI nënkupton të pajisurit e brezit të ri me mjetet dhe teknikat e duhura për të dalluar të vërtetën kundrejt retorikës manipulative, si dhe me njohuri për t'i ndihmuar ata të gjykojnë mbi bazë të informacionit dhe normave etike.

Në Shqipëri EMI mbetet ende një koncept i pastudiuar gjerësisht, prandaj nuk mund të flasim për politika zyrtare të implementuara në këtë fushë. Përpjekje për të analizuar situatën janë bërë përmes publikimeve të Institutit Shqiptar të Medias (ISHM) qysh prej vitit 2009 për EMI-in drejtuar mësuesve, nxënësve, gazetarëve, etj.;<sup>1</sup> një botim i Departamentit të Gazetarisë dhe Komunikimit në Universitetin e Tiranës mbi rolin e medias në kurrikulën e arsimit të mesëm,<sup>2</sup> si dhe një manual për „aftësimin mediatik në shkollat e mesme“, nga Instituti për Demokraci, Media dhe Kulturë (IDMC) që vendos në fokus aftësimin e të rinjve për të zbuluar informacionet e pasakta, lajmet e rreme, fotografitë e retushuara etj. Modulet e propozuara në këtë manual synonin të ndihmonin jo vetëm nxënësit, por edhe mësuesit gjatë orës së mësimi.<sup>3</sup>

Nga trajnimet që autorja e këtij punimi ka pasur me nxënës dhe studentë në gjimnaze dhe fakultete të ndryshme të vendit, ka rënë në sy se jo të gjithë të rinjtë mund të mendojnë në mënyrë kritike mbi zhvillimet teknologjike, mbi lajmet e rreme, mbi mënyrën si informohen dhe mbi të gjitha nuk janë gjithmonë në gjendje të argumentojnë mbi lajmet që shohin në TV apo lexojnë online. Prandaj aftësimi për të dalluar informacionet e vlefshme në internet, për të përfshirë në mënyrë kritike mediat e reja në procesin e të nxënës mbetet prioritar. Por, pa mësuesit i gjithë ky proces do të jetë i

<sup>1</sup> Godole, J., Musai, B., Abdurrahimi, T., (2011). *Media Literacy. Doracak për mësues dhe nxënës, Klasa 1-9* [Handbook for Teachers and Students, Classes 1-9], ISHM: Tirana.

Janjic, S. dhe Dervishi, L. (2019). Manual për trajnerët. Edukimi për median dhe informacionin, ISHM: Tirana. <http://www.institutemedia.org/Documents/PDF/TotManual.pdf> (aksesuar online 21.10.2020)

Jusovic´ R. L. dhe Krajišnik, N. (2020). Udhëzues për gazetarët për edukimin në fushën e medias dhe të informacionit, ISHM: Tirana <http://www.institutemedia.org/ep-content/uploads/2020/09/udhezuesgaz.pdf> (aksesuar online 22.10.2020).

Londo, I., Petković, B. dhe Hrvatin, B. S. (2019). Roli i institucioneve publike në zhvillimin e edukimit mbi median dhe informacionin në Shqipëri, ISHM: Tirana. [http://www.cimusee.org/media/18446/plusalbania\\_rol-i-institucioneve-publike-ne-zhvillimin-e-edukimit-mbi-median-dhe-informacionin-ne-shqiperi.pdf](http://www.cimusee.org/media/18446/plusalbania_rol-i-institucioneve-publike-ne-zhvillimin-e-edukimit-mbi-median-dhe-informacionin-ne-shqiperi.pdf) (aksesuar 22.10.2020)

<sup>2</sup> DGK (2012). Mediologjia: Vendi i saj në korrikulat e arsimit të mesëm si pjesë e edukimit qytetar të rinisë shkollore. *Studime Albanologjike*. FHF: Tirana

<sup>3</sup> Godole, J. (2020). Manual për aftësimin mediatik në shkollë. Me materiale ndihmëse për mësues dhe nxënës. IDMC: Tirana <https://idmc.al/assets/idmc-manual-per-aftesimin-mediatik-ne-shkollë.pdf> (aksesuar 18.10.2020)

vështirë. Janë ata të parët që duhet të zotërojnë teknikat dhe mjetet e EMI-t përpara se t'ua mësojnë nxënësve.

Synimi i këtij punimi është të hedhë dritë mbi gjendjen e EMI-t në Shqipëri, të evidentojë problematikat e fushës si dhe të japë disa rekomandime se si mund të përmirësohet situata në të ardhmen.

## **EMI në axhendën digjitale**

Digjitalizimi ka përfshirë të gjitha fushat e jetës edhe në Shqipëri dhe kjo padyshim e ka vendosur systemin arsimor përpara sfidave të reja. Prindërit jo gjithmonë mund t'i ndjekin fëmijët e tyre në çdo hap të shpejtë që bën teknologjia. Shkollës dhe institucioneve edukative u bie barra më e madhe për të orientuar dhe pajisur të rinjtë me kompetenca për të jetuar dhe punuar në shekullin 21. Por edhe vetë mësuesit dhe pedagogët duhet të jenë të përgatitur për këtë sfidë.

Studentët e tanishëm të degës së mësuesisë i përkasin një brezi që është rritur me larmi mediash. Kjo ka të mirën e vet, sepse do të bëjë dallimin në të ardhmen për përfshirjen në mënyrë më kreative të mediave në orën e mësimit. Megjithatë përdorimi profesional i tyre në përgjithësi është pak ose aspak i njohur. Profesionaliteti i mësuesve si kur studiojnë në auditorët e universitetit ashtu edhe në shkollë nuk duket thjesht te aftësimi teknik mbi mediumet e ndryshme. Kërkohen aftësi dhe njohuri didaktike që jo vetëm t'i përdorin mediat, por edhe të reflektojnë saktë mbi aspektet kulturore, sociale e shoqërore që shpalosen në një botë digjitale. Për fat të keq ky aftësim nuk ndodh në shkollën e lartë për mësuesit e ardhshëm.

Duket sikur i gjithë zhvillimi i sistemit arsimor në këtë drejtim është i mbingarkuar. Nuk ka as trupë të mjaftueshme mësimore, as pajisje të duhura teknike dhe as koncepte të qëndrueshme për edukimin mbi median dhe informacionin në shkolla. Prindërit nuk janë detyrimisht një ndihmë në këtë drejtim, pasi ata, në varësi të moshës dhe statusit social, ose nuk e kuptojnë qasjen e fëmijëve të tyre ndaj internetit ose e kanë të pamundur ta aksesojnë atë. Që edukimi mbi median dhe informimin të funksiononte ai duhet të aplikohet qysh në sistemin parashkollor në mënyrë adekuate dhe nga edukatorë dhe mësues të trajnuar me bazat e EMI-t.

Pandemia e Covid-19 tregoi se sistemet arsimore duhet të jenë më të përgatitura se kurrë për të përballuar kërkesat e botës digjitale. Edhe për sistemin arsimor shqiptar del nevoja për ta orientuar mësimin drejt përdorimit të mediave digjitale. Për ta arritur këtë duhet të përmbushen fillimisht disa kërkesa bazike: a) Shkolla duhet të hapet realisht ndaj mediave digjitale, përmes platformave të ndryshme të internetit; b) Mësuesit duhet të kuptojnë qasjen e natyrshme të nxënësve të tyre ndaj mediave online. Ata duhet të jenë në gjendje t'u shpjegojnë atyre ndikimet sociale dhe kulturore të digjitalizimit. Kjo kërkon një zgjerim të aftësive teorike të mësuesve dhe trajnim intensiv të vazhdueshëm në këtë fushë.

Për të kuptuar praninë e të rinjve në internet dhe rreziqet që mund t'u kanosen atyre për shkak të mungesës së njohurive në lidhje me mediat dhe mesazhet mediatike, mjaftojmë të shohim disa të dhëna zyrtare. Sipas të dhënave të AKEP-it (Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare) për vitin 2020 u regjistruan mbi 3.3 milionë përdorues aktivë të

telefonisë celulare për një popullsi prej 3 milionë banorësh.<sup>4</sup> Ky fakt dëshmon shkallën e lartë penetruese të internetit dhe shkëmbimin e informacionit në popullatë. Sipas një studimi, 67% e të anketuarve në grupmoshën 18-35 vjeç u shprehën se e përdornin internetin si mjetin kryesor të informimit, krahasuar me 30% të të rinjve që ndiqnin televizionin, dhe shumë pak prej tyre informoheshin përmes radios apo shtypit.<sup>5</sup>

Në një shkallë më të gjerë, Barometri i Ballkanit 2020 tregon se interneti përdoret gjerësisht për qëllime komunikimi me përhapje të shpejtë në mediat sociale (69%) ndërsa më pak e popullarizuar për edukim (30%) dhe për blerje online (22%).<sup>6</sup> Edhe pse ka pra një prirje të qartë për të përdorur internetin dhe rrjetet sociale për qëllime informimi, aftësia e popullsisë për të gjykuar në mënyrë kritike burimet dhe përmbajtjen mediatike mbetet ende e kufizuar. Kështu mund të lexohet renditja e ulët e Shqipërisë në *Media Literacy Index* për vitin 2020<sup>7</sup> (bashkë me Bosnjën, Maqedoninë e Veriut, Turqinë dhe Malin e Zi) për mungesën e kompetencës për të gjykuar me filtrat e duhur analitikë në epokën e lajmit të rremë dhe post-të vërtetës. Vlen të theksohet se indeksi ulet më tepër në varësi të disa parametrave, si perceptimi sa më i lartë mbi korrupsionin; mungesa e besimit te ekspertët e vendit; mungesa e besimit te gazetarët dhe media.

## **Edukim i mësuesve apo i nxënësve?**

Aftësimi i të rinjve për të kuptuar median është edhe pjesë e edukimit qytetar të tyre. Të rinjtë duhet të fuqizohen për të marrë vendime të ndërgjegjshme dhe kompetente për të artikuluar interesat e tyre. Në këtë drejtim një qëllim parësor në procesin mësimor duhet të ishte zhvillimi i pavarësisë digjitale. Kështu që fokusimi vetëm te kompetencat individuale të mësuesve nuk mjafton për të realizuar këtë qëllim. Synimi duhet të ishte ngritja e një kulture më të gjithanshme të të nxënësve dhe reflektimit. Që studentët të përgatiten denjësisht për të transmetuar dije në një shoqëri digjitale kur të jenë mësues, i gjithë cikli i studimeve të tyre duhet të jetë i orientuar në këtë drejtim. Të ofrojnë mundësi për reflektim dhe ushtrim të mediave, të cilat do të përdoren më vonë si një mjet, por edhe si një objekt mësimor dhe instrument për të udhëhequr nxënësit në procesin e EMI-t. Për ta arritur këtë:

- EMI duhet të jetë një pjesë e detyrueshme e studimeve për mësuesi dhe pedagogji dhe të asistohet nga staf i kualifikuar në teorinë, kërkimin shkencor dhe praktikën e medias;
- Kompetenca për EMI-n duhet të jetë një komponent i rëndësishëm në vlerësimin me notë përmbyllëse të studimeve, që do të rriste edhe autoritetin e studimeve universitare të fushës;
- Temat që lidhen me median, proceset e zhvillimit të saj, dhe sfidat në shoqërinë digjitale duhet të plotësojnë edukimin në lëndën e detyrueshme të EMI-t;

<sup>4</sup> AKEP (2020). Treguesit Statistikor të Tregut të Komunikimeve Elektronike, fq. 7. [https://www.akep.al/wp-content/uploads/2019/01/Raport-T4\\_2020-Publikim.pdf](https://www.akep.al/wp-content/uploads/2019/01/Raport-T4_2020-Publikim.pdf) (aksesuar 28.4.2021).

<sup>5</sup> Mema, B. (2016). Dilemmas on information in the digital era – the Albanian case. In: Albanian Media Institute, *Online media in Albania: legislation, self-regulation, development, and main tendencies*. ISHM: Tirana.

<sup>6</sup> Balkan Barometer 2020. Public Opinion. Analytical Report. 2020-06-Balkan-Barometer-Public-Opinion\_final.pdf (aksesuar 22.10.2020).

<sup>7</sup> Lessinski, M. (2019). Just think about it. Findings of the Media Literacy Index 2019. Open Society Institute: Sofia. [https://osis.bg/wp-content/uploads/2019/11/MediaLiteracyIndex2019\\_-ENG.pdf](https://osis.bg/wp-content/uploads/2019/11/MediaLiteracyIndex2019_-ENG.pdf) (aksesuar 22.10.2020).

Kompetenca për EMI-n mund të ishin të nevojshme dhe të aplikoheshin në degë të ndryshme, si:

- a) **Shkencat pedagogjike** (mbi teoritë e edukimit dhe historikun e zhvillimit të tyre);
- b) **Didaktikën mësimore** (në lidhje me rëndësinë e mediave për orën dhe procesin e mësimin);
- c) **Gazetari dhe Komunikim** (për rrezikun e fëmijëve kundrejt internetit, propagandës online dhe në rrjetet sociale, gjuhës së urrejtjes, lajmeve të rreme, etj.);
- d) **Sociologji** (për përdorimin e mediave nga fëmijët dhe të rinjtë si dhe pasojat e tyre);
- e) **Psikologji** (për rëndësinë e mediave në psikologjinë e zhvillimit të të rinjve);
- f) **Degë të profilit juridik** (në lidhje me përdorimin e mediave, për aspekte të mbrojtjes së të dhënave, të drejtat e fëmijëve, etj.)

## Rekomandime

Që këto kompetenca të mund të shpalosen në orën e mësimin është thelbësor aksesi i shpejtë dhe i sigurtë i internetit në shkolla, materiale mësimore digjitale, mbështetje teknike për problemet që mund të dalin si dhe hapësira ku nxënësit të mund të ushtrohen në praktikë. Edhe pse qeveria shqiptare në të ashtuquajturën “Akhenda digjitale e Shqipërisë 2015-2020” e rendit lëndën e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) si prioritet në kurrikulën shkollore<sup>8</sup> vetë ata e pranojnë se përdorimi i TIK-ut në institucionet arsimore është i kufizuar për shkak të mangësive teknike kryesisht, dhe dobësive të tjera të sistemit arsimor. Sidoqoftë TIK pavarësisht rëndësisë që ka, nuk e zëvendëson edukimin e brezit të ri mbi rolin e edukimit digjital, të medias dhe informacionit.

Prandaj bazuar në kontekstin shqiptar sa më sipër, japim këto rekomandime:

- Ministria e Arsimit dhe Sportit duhet të krijojë kushtet e duhura dhe të vërë në dispozicion mjetet e duhura financiare për trajnimin e trupës mësimore dhe pajisjen e institucioneve arsimore në frymën e epokës digjitale;
- Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASAP) dhe drejtoritë e saj, si ajo e Zhvillimit të Kurrikulës të përgjigjet për vlerësimin e nevojave për zhvillimin profesional të programeve dhe materialeve plotësuese në fushën e EMI-t dhe të mbështesë kualifikimet e nevojshme të personelit arsimor;
- Institucionet e arsimit të lartë që formojnë mësuesit e ardhshëm duhet të motivohen për të rritur kapacitetet e tyre në fushën e EMI-t. Vetëm trajnimet e vazhdueshme të mësuesve mund ta çojnë seriozisht përpara “Akhendën Digjitale”;

---

<sup>8</sup> Strategjia ndërsektoriale: Axhenda dixhitale e Shqipërisë 2015-2020. [https://akshi.gov.al/wp-content/uploads/2018/03/Strategjia\\_Axhenda\\_Dixhitale\\_e\\_Shqiperise\\_2015-2020.pdf](https://akshi.gov.al/wp-content/uploads/2018/03/Strategjia_Axhenda_Dixhitale_e_Shqiperise_2015-2020.pdf)

- Shkollat dhe universitetet duhet të punojnë ngushtësisht për të zhvilluar peizazhin arsimor. Shkollat e larta të krijojnë profile të reja studimi për të zhvilluar ekspertizë në fushën e EMI-t;
- Kualifikimet dhe studimet pranë Departamenteve të Gazetarisë dhe Komunikimit në vend duhet të mendohen si ndërdisiplinore në mënyrë që të garantojnë ide inovatore në trajtimin e EMI-t;
- Bashkëpunim të ngushtë me aktorë dhe institucione të shoqërisë civile që japin kontribut në këtë fushë dhe kanë përvojë dhe ekspertizë profesionale për t'i trajnuar mësuesit dhe forcuar kapacitetet e EMI-t për nxënës dhe staf mësues;
- Raporte dhe anketa të vazhdueshme që analizojnë perceptimet e të rinjve në lidhje me EMI-n në epokën digjitale, si dhe problematika të aplikimit të saj në kurrikulën shkollore;
- Ndihmë edhe nga institucionet ndërkombëtare duke i sensibilizuar ato për këtë problem të përbashkët; një Shqipëri me një indeks të dobët të EMI-t dobëson edhe vetë Bashkimin Europian, ku vendi synon të integrohet.